

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI” NDEROI ME TITULLIN
“DOCTOR HONORIS CAUSA” PROF. DR. GJERGJ SINANIN**

Në datën **27 tetor 2017** në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane u zhvillua veprimtaria e dhënies së titullit “*Doctor Honoris Causa*” pedagogut të shkencave filozofike në Universitetin e Tiranës, **Prof. dr. Gjergj Sinanit**. Dekani i fakultetit, **Prof. dr. Gjergji Pendavinji** në fjalën e hapjes, vlerësoi veprën akademike si edhe kontributin e profesor Sinanit në Universitetin e Korçës.

Në emër të Senatit Akademik, rektori i Universitetit, **Prof. dr. Ali Jashari** i dorëzoi titullin shoqëruar me **Medaljen e Artë** të institucionit, me motivacionin: “*Personalitet i shquar i arsimit të lartë në Shqipëri; filozof, studiues, autor tekstesh mësimore, publicist, përkthyes dhe veprimtar shoqëror, për ndihmesa të çmuara dhënë Universitetit “Fan S. Noli” në mësimdhënien e shkencave filozofike dhe organizimin e veprimtarive shkencore-botuese*”.

Prof. dr. Gjergj Sinani falënderoi Universitetin e Korçës për vlerësimin dhe mbajti leksionin “*Filozofia dhe roli i saj në jetën e njeriut*”.



